

	KONKURS PUBLIK	DT-BNJ-027
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 1 nga 17</i>
<i>Departamenti i Burimeve Njerëzore</i>		<i>Sektori i Personelit</i>

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës, nenin 5 (paragrafi 1, 2, 4, 5) dhe nenit 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT-nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenin 6.2 dhe 9.2 të Politikës së rekrutimit, Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut-KOSTT sh. a. për plotësim të vendeve të lira të punës si më poshtë, shpall:

KONKURS PUBLIK

1. Auditor/e për çështje ekonomike, ligjore dhe rregullative (1 kryes)
2. Operator/e në nivelin 110(220)/x kV/kV (3 kryes)
3. Teknik/e Elektrik Specialist për Mirëmbajtje dhe Riparim të Nënstacioneve (2 kryes)
4. Operator/e -Ngasës i makinës speciale (1 kryes)
5. Teknik/e Specialist për Mirëmbajtje dhe Riparim të Linjave (3 kryes)
6. Depoist/e llogaritar (1 kryes)
7. Inxhinier/e për testim, mirëmbajtje dhe akordim të releve (rishpallje) (1 kryes)
8. Inxhinier/e për planifikim operativ dhe analizë afat-shkurtë (1 kryes)

Titulli i vendit të punës:	Auditor/e për çështje ekonomike, ligjore dhe rregullative
Ndërmarrja:	KOSTT - Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh.A.
Numri referues:	1.0.3.1
Kohëzgjatja e kontratës:	Për kohë të pacaktuar
Orari i punës:	Puna me orar të plotë
Lartësia e pagës bazë mujore:	1014 euro
Numri i kryesve:	1
Kushtet e punës:	Puna në Zyrë
Vendi i punës (lokacioni):	Drejtoria -Prishtinë
Mënyra e aplikimit:	Adresa elektronike (email)

Përmbledhje e detyrave për pozitën: Auditor për çështje ekonomike, ligjore dhe rregullative

Auditori për çështje ekonomike, ligjore dhe rregullative është përgjegjës për kryerjen e auditimeve të brendshme në përputhje me "Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm" dhe për ofrimin e sigurisë së arsyeshme që organizata është në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Detyra kryesore e tij/saj është të ndihmojë në menaxhimin e rrezikut dhe të sigurojë që sistemet e kontrollit të brendshëm janë efektive dhe të qëndrueshme.

Auditori ka për qëllim të ofrojë një vlerësim të pavarur dhe objektiv për proceset e menaxhimit të rrezikut, kontrollit të brendshëm dhe qeverisjes në organizatë. Duke përdorur një qasje të strukturuar dhe metodologji sistematike, auditori kontribuon në përmirësimin e funksionimit të organizatës në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore

- Përgatitja e planit të auditimit të njësisë së audituar bazuar në vlerësimin e rrezikut, duke marrë parasysh objektivat strategjike të organizatës;
- Bashkëpunimi me Zyrtarin për Auditim të Brendshëm për të zhvilluar planin strategjik dhe planin vjetor të auditimit;
- Identifikimi i fushave kritike që kanë nevojë për auditim dhe përcaktimi i objektivave të auditimit;
- Zhvillimi i intervistave dhe pyetësorëve në fazën e planifikimit;
- Përzgjedhja e mostrave me metodat statistikore dhe sipas gjykimit profesional;
- Zhvillimi i auditimeve në përputhje me planin e miratuar dhe standardet për auditim të brendshëm;
- Mbledhja e të dhënave dhe dokumenteve relevante për vlerësimin e rregullsisë dhe efektivitetit të proceseve të kontrollit të brendshëm;
- Kryerja e testeve substanciale dhe të detajeve sipas planit të auditimit;
- Vizitat dhe ekzaminimet fizike në teren sipas nevojës, vlerësimi i përputhshmërisë së organizatës me ligjet dhe rregulloret përkatëse në fushat ekonomike, financiare dhe ligjore;
- Vlerësimi i dizajnit dhe efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm për të menaxhuar rreziqet dhe për të përmirësuar performancën operacionale dhe financiare;
- Hartimi i draft-raporteve të auditimit që përfshijnë gjetjet kryesore, analizat e rreziqeve, dhe rekomandimet për përmirësim si dhe trajtimi i komenteve nga pala e audituar dhe menaxhmenti;
- Ofrimi i rekomandimeve për përmirësimin e kontroleve të brendshme dhe për uljen e rreziqeve që lidhen me pajtueshmërinë ligjore dhe aspektet financiare;
- Mbajtja e dokumentacionit të saktë dhe të plotë për çdo fazë të auditimit në përputhje me standardet ndërkombëtare, rregullat lokale dhe politikën e organizatës;
- Përcjellja e progresit në zbatimin e rekomandimeve nga njësitë e audituara për të siguruar që rekomandimet janë implementuar në mënyrë efektive;
- Bashkëpunimi me departamentet e tjera të organizatës për të kuptuar proceset e tyre dhe për të ndihmuar në identifikimin e fushave me rrezik të lartë;
- Komunikimi i vazhdueshëm me njësitë e audituara, menaxhmentin si dhe me auditorët e jashtëm dhe të brendshëm për çështjet që ndërliohen me fushën e auditimit;
- Raportimi i rregullt dhe me kërkesë nga Zyrtari për Auditim të Brendshëm mbi progresin e punës për auditimet e kryer;
- Ofrimi i konsulencës profesionale për stafin dhe menaxhmentin lidhur me praktikat më të mira të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin e rrezikut;
- Përmirësimi i njohurive për ndryshimet në ligje dhe rregullore që ndikojnë organizatën dhe proceset e auditimit.

Pavarësia: *Auditori për çështje ekonomike, ligjore dhe rregullative* duhet të jetë në gjendje që ta kryej punën e tij në mënyrë të pavarur dhe objektive. Të paraqet gjykim të paanshme dhe të drejtpërdrejt që janë me rëndësi esenciale për kryerjen e duhur të angazhimeve të auditimit të brendshëm.

Në mënyrë funksionale, *Auditori për çështje ekonomike, ligjore dhe rregullative* i raporton Zyrtarit për *Auditim të Brendshëm*, duke siguruar një nivel të lartë të pavarësisë së auditorit.

Autorizimet:

Auditori për çështje ekonomike, ligjore dhe rregullative, gjatë procesit të auditimit ka qasje në të gjithë lokacionin e KOSTT-it, në çdo lloj baze të të dhënave, dokumenti, fajlli, korrespondence, llogarie, dosje etj. të nevojshme për kryerjen e punës së tij/saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe procedurat e brendshme.

Standardet Profesionale:

Auditor për çështje ekonomike, ligjore dhe rregullative, punën e vet e kryen në harmoni me Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm, Manualin për Auditim të Brendshëm, legjislacionin dhe rregullat vendore, Kodin Etik dhe Qeverisjen Korporative.

Të tjera

Kryen detyra të tjera siç mund të kërkohen nga Inxhinieri i Mirëmbajtjes dhe Riparimit të Linjave dhe si të jetë e nevojshme për funksionimin efikas të KOSTT.

Kërkesat profesionale/Kualifikimet, aftësitë dhe shkathtësitë tjera:

Shkollimi: Diplomë universitare në

Dega/drejtimi/lëmia: Ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike, ose fusha të tjera të studimeve relevante për sektorin që do të auditohet

- Të ketë së paku katër (4) vite përvojë pune profesionale në auditim nga momenti i përfundimit të studimeve në sektor publik dhe/ose privat në ndërmarrje ose organizata të madhësisë dhe kompleksitetit të ngjashëm me ndërmarrjen. Përvoja në auditim të projekte të financuara nga donatorët konsiderohet përparësi.
- Të jetë auditor i brendshëm i certifikuar sipas nenit 22 pika 2.2 të Ligji Nr.06/L-021.
- Certifikime të tjera në fushën e kontabilitetit, financave, dhe/ose auditimit nga shoqatat e njohura vendore dhe ndërkombëtare në fushën e sektorit publik konsiderohen përparësi.
- Të ketë njohuri të thellë nga fusha e sektorit publik, qeverisjes korporative dhe financiare;
- Nuk është i dënuar me aktgjykim të formës së prerë për kryerjen e veprës penale të dënueshme së paku gjashtë (6) muaj;
- Demonstrimi i aftësive të shkëlqyeshme për analizim dhe definim të problemeve, fakteve dhe për dhënie të rekomandimeve dhe konkluzioneve të bazuara në dëshmi;
- Demonstrimi i aftësive të shkëlqyeshme të komunikimit dhe të bashkëpunimit me menaxhmentin dhe stafin e Ndërmarrjes;
- Preferohet njohje e mirë e gjuhës angleze.

Njoftimi me rezultatin e konkursit

Sipas udhëzimit administrativ nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik aplikantët/kandidatët do të njoftohen pas çdo faze të zhvillimit të procesit të vlerësimit të kandidatëve

Mënyra e vlerësimit të aplikantëve/kandidatëve

Sipas udhëzimit administrativ nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik Testi me shkrim vlerësohet deri në shtatëdhjetë (70) pikë

Intervista deri në njëzet (20) pikë

Jetë përshkrimi (CV) deri në dhjetë (10) pikë

Titulli i vendit të punës:	Operator/e në nivelin 110 (220)/x kV/ kV
Ndërmarrja:	KOSTT - Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh.A.
Numri referues:	1.6.7.7
Kohëzgjatja e kontratës:	Për kohë të pacaktuar
Orari i punës:	Puna me orar të plotë
Lartësia e pagës bazë mujore:	617 euro
Numri i kryesve:	3
Kushtet e punës:	Puna në Nënstacione
Vendi i punës (lokacioni):	NS Fushë Kosova
Mënyra e aplikimit:	Adresa elektronike (email)

Përmbledhje e detyrave për pozitën: Operator në nivelin 110(220)/xkV/ kV

Është përgjegjësi kryesor për të gjitha manipulimet në NS 110/10 kV. Gjatë tërë orarit të punës duhet të bashkëpunojë ngushtë me Dispeçerin e Qendrës Nacionale (QND), përgjegjësin e NS dhe Menaxherin e Operimit. Me urdhër të Dispeçerit operon me stabilimentet në NS, në funksionim të mbarëvajtjes së tërësishme të KOSTT dhe SEE në tërësi. Operimi do të vazhdojë deri në kalimin e operimit nga QND përmes SCADA sistemit.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore

Përmes Dispeçerëve të QND, Operatorët kryejnë të gjitha operimet e mundshme për mbikëqyrjen, operimin dhe mirëmbajtjen e nënstacioneve dhe linjave. Detyrat dhe përgjegjësitë e tij specifike janë:

- Zbatimi në përpikëri i Procedurës për Operim
- Operimi me të gjitha llojet e pajisjeve elektrike në emër të dispeçerit
- Monitorimi i performancës së nënstacionit
- Shënimi i performancës dhe incidenteve në nënstacione dhe raportimi i tyre
- Mbajtja e shënimeve për të gjitha veprimtaritë në nënstacion
- Evidentimi i kohës së operimeve
- Mban evidencë për gjendjen e furnizimit vetanak, e në rast nevojë lajmëron Menaxherin për Operim
- Evidentimi i rënieve të stabilimenteve elektroenergjetike në kohë reale, deshifrimi i mbrojtjeve të cilat kanë vepruar
- Vrojtimi dhe evidentimi i gjendjeve jonormale në fushat në eksploatim, lajmërimi i tyre tek dispeçeri
- Periodikisht bënë vrojtimin e gjendjes së stabilimenteve elektroenergjetike të trafostacionit dhe raportimit
- Ruan dokumentacionin teknik të trafostacionit
- Mban pastërtinë në objekt
- Gjatë tërë orarit të punës nuk guxon të largohet nga objekti
- Sipas nevojës, Menaxheri i Operimit me NS e cakton në NS e të njëjtit nivel në të cilin duhet të punojë

Të tjera

Kryen detyra tjera të cilat kërkohen nga përgjegjësi i nënstacionit apo Menaxherit të Operimit me NS dhe të cilat janë të nevojshme për funksionimin efektiv të KOSTT-it dhe sistemit në tërësi.

Kërkesat profesionale/Kualifikimet, aftësitë dhe shkathtësitë tjera:

Shkollimi: Diploma e Shkollës së mesme Elektronike apo Teknike
Dega/drejtimi/lëmia: Elektroenergjetikë, Instalime Elektrike apo ngjashëm

- Përvojë pune profesionale minimum 6 muaj (të dëshmuara)
- Njohja e punës me kompjuter
- Besueshmëria dhe përpikëria

Njoftimi me rezultatin e konkursit

Sipas udhëzimit administrativ nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik aplikantët/kandidatët do të njoftohen pas çdo faze të zhvillimit të procesit të vlerësimit të kandidatëve

Mënyra e vlerësimit të aplikantëve/kandidatëve

Sipas udhëzimit administrativ nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik Testi me shkrim vlerësohet deri në shtatëdhjetë (70) pikë
Intervista deri në njëzet (20) pikë
Jetë përshkrimi (CV) deri në dhjetë (10) pikë

Titulli i vendit të punës:	Teknik/e Elektrik Specialist për Mirëmbajte dhe Riparim të Nënstacioneve
Ndërmarrja:	KOSTT - Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh.A.
Numri referues:	1.6.3.4
Kohëzgjatja e kontratës:	Për kohë të pacaktuar
Orari i punës:	Puna me orar të plotë
Lartësia e pagës bazë mujore:	699 euro
Numri i kryesve:	2
Kushtet e punës:	Puna në teren
Vendi i punës (lokacioni):	Punëtorja dhe Depoja KOSTT, Obiliq
Mënyra e aplikimit:	Adresa elektronike (email)

Përmbledhje e detyrave për pozitën: Teknik Elektrik Specialist për Mirëmbajte dhe Riparim të Nënstacioneve

Tekniku elektrik specialist i Mirëmbajtjes dhe Riparimit i ndihmon Udhëheqësit të grupit dhe Koordinatorit të Grupeve të Mirëmbajtjes dhe Riparimit të Nënstacioneve në kryerjen e punëve riparuese lidhur me mirëmbajtjen e nënstacioneve në nivelin 400/220/110 kV.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore

Detyrat dhe përgjegjësitë e tij specifike janë ndihma dhe mbështetja në kuptim të:

- Kryerja e punëve të ndryshme të mirëmbajtjes dhe ndërtimore në nënstacione në nivelin 400/220/110kV.
- Siguroj qasje të sigurte në nënstacione për mirëmbajtje dhe punë të reja ndërtimore.
- Gjatë tërë kohës merr masa të menjëhershme përmirësuese në rast të devijimit të performancës në nënstacione në nivelin 400/220/110kV.
- Gjatë intervenimeve dhe riparimeve bënë përdorimin e drejtë të veglave dhe pajisjeve të punës, si dhe përkujdeset për procedurat e sigurisë në punë.
- Sipas nevojës ndihmon ekipin, dhe kryen punë sipas kërkesës së eprorit.
- Merr pjese ne sistemimin dhe klasifikimin e materialeve te përdorura ne punëtori.
- Merr pjese ne planifikimin e materialeve dhe pjesëve rezerve për periudha te ndryshme.
- Merr pjese ne kryerjen e remonteve të pajisjeve primare sipas planit te mirëmbajtjes.
- Bashkëpunon me sektorët tjera ne KOSTT sipas nevojës.
- Kujdeset për implementimin e procedurave dhe rregullores se sigurisë ne pune.

Të tjera

Kryen detyra të tjera siç mund të kërkohen nga Inxhinieri i Mirëmbajtjes dhe Riparimit të Nënstacioneve dhe si të jetë e nevojshme për funksionimin efikas të KOSTT-it.

Kërkesat profesionale/Kualifikimet, aftësitë dhe shkathtësitë tjera:

Shkollimi: Shkolla e mesme teknike
Dega/drejtimi/lëmia: Elektrikë

- Përvojë profesionale 2 vite
- Përvojë në pajisjet e tensionit të lartë
- Njohuri të sektorit të shërbimeve publike nga perspektiva teknike

Njoftimi me rezultatin e konkursit

Sipas udhëzimit administrativ nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik aplikantët/kandidatët do të njoftohen pas çdo faze të zhvillimit të procesit të vlerësimit të kandidatëve

Mënyra e vlerësimit të aplikantëve/kandidatëve

Sipas udhëzimit administrativ nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik Testi me shkrim vlerësohet deri në shtatëdhjetë (70) pikë

Intervista deri në njëzet (20) pikë

Jetë përshkrimi (CV) deri në dhjetë (10) pikë

Titulli i vendit të punës:	Operator/e - Ngasës i makinës speciale
Ndërmarrja:	KOSTT - Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh.A.
Numri referues:	1.6.3.9
Kohëzgjatja e kontratës:	Për kohë të pacaktuar
Orari i punës:	Puna me orar të plotë
Lartësia e pagës bazë mujore:	678 euro
Numri i kryesve:	1

Kushtet e punës: Puna në teren
Vendi i punës (lokacioni): Punëtorja dhe Depoja KOSTT, Obiliq
Mënyra e aplikimit: Adresa elektronike (email)

Përmbledhje e detyrave për pozitën: Operator/Ngasës i makinës speciale

Operatori/Ngasësi i makinës speciale vozitë dhe mirëmban automjetet për qëllime të posaçme si dhe automjetet tjera të autoparkut.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore

Detyrat dhe përgjegjësitë e tij specifike lidhur me vozitjen dhe masat e mirëmbajtjes janë:

- Vozitja e automjeteve të posaçme si makineritë me pesha e larta.
- Mirëmbajtja e automjeteve për qëllime të posaçme.
- Kryerja e mirëmbajtjes së rregullt preventive dhe masat riparuese në autopark.
- Riparimi dhe zëvendësimi i pjesëve të vjetruara dhe dëmtuara.

Të tjera

Kryen detyra të tjera të cilat kërkohen nga Menaxheri i Sektorit të Mirëmbajtjes dhe Riparimit të QP dhe të cilat kërkohen për funksionimin efektiv të KOSTT-it.

Kërkesat profesionale/Kualifikimet, aftësitë dhe shkathtësitë tjera:

Shkollimi: Shkolla joformale pas përfundimit të shkollës së mesme ose edukim joformal apo Praktikë

Dega/drejtimi/lëmia:

- Patentë shoferi
- Patentë shoferi special kategoria C, D
- Përvojë pune profesionale 2 vite
- Aftësi udhëheqëse dhe administrative

Njoftimi me rezultatin e konkursit

Sipas udhëzimit administrativ nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik aplikantët/kandidatët do të njoftohen pas çdo faze të zhvillimit të procesit të vlerësimit të kandidatëve

Mënyra e vlerësimit të aplikantëve/kandidatëve

Sipas udhëzimit administrativ nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik

Testi me shkrim vlerësohet deri në shtatëdhjetë (70) pikë

Intervista deri në njëzet (20) pikë

Jetë përshkrimi (CV) deri në dhjetë (10) pikë

Titulli i vendit të punës: Teknik/e Specialist për Mirëmbajtje dhe Riparim të Linjave
Ndërmarrja: KOSTT - Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh.A.
Numri referues: 1.6.2.5

Kohëzgjatja e kontratës:	Për kohë të pacaktuar
Orari i punës:	Puna me orar të plotë
Lartësia e pagës bazë mujore:	717 euro
Numri i kryesve:	3
Kushtet e punës:	Puna në teren
Vendi i punës (lokacioni):	Punëtorja dhe Depoja KOSTT, Obiliq
Mënyra e aplikimit:	Adresa elektronike (email)

Përmbledhje e detyrave për pozitën: Teknik Specialist i Mirëmbajtjes dhe Riparimit të Linjave

Tekniku Specialist i Mirëmbajtjes dhe Riparimit të Linjave i ndihmon Inxhinierit të Mirëmbajtjes dhe Riparimit të Linjave dhe Udhëheqësit të Grupit të Mirëmbajtjes dhe Riparimit të Linjave në kryerjen e punëve riparuese në mirëmbajtjen e linjave të KOSTT.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore

Detyrat dhe përgjegjësitë e tij specifike janë ndihma dhe mbështetje në kuptim të:

- Kryerja e të gjitha llojeve të punëve në mirëmbajtje dhe ndërtim në linjat e transmisionit.
- Sigurimi i qasjes së sigurve në linja për mirëmbajtje dhe punë të reja ndërtimore.
- Gjatë tërë kohës ndërmerr masa të menjëhershme përmirësuese në rast të devijimit të performancës.
- Gjatë intervenimeve dhe riparimeve bënë përdorimin e drejtë të veglave dhe pajisjeve të punës, si dhe përkujdeset për procedurat e sigurisë në punë.
- Kryen aktivitete të punëve mbështetëse të përgatitjes teknike në punëtori dhe teren për mirëmbajtjen dhe riparimin e linjave
- Zbaton me përpikëri politiken e masave të sigurisë të miratuara nga KOSTT-i.
- Sipas nevojës vozitë për ekipin e mirëmbajtjes.

Të tjera

Kryen detyra të tjera siç mund të kërkohen nga Inxhinieri i Mirëmbajtjes dhe Riparimit të Linjave dhe si të jetë e nevojshme për funksionimin efikas të KOSTT.

Kërkesat profesionale/Kualifikimet, aftësitë dhe shkathtësitë tjera:

Shkollimi: Shkolla e mesme teknike

Dega/drejtimi/lëmia: Elektroteknikës

- Përvojë pune profesionale 2 vite
- Njohuri të industrisë së shërbimeve publike nga perspektiva teknike

Njoftimi me rezultatin e konkursit

Sipas udhëzimit administrativ nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik aplikantët/kandidatët do të njoftohen pas çdo faze të zhvillimit të procesit të vlerësimit të kandidatëve

Mënyra e vlerësimit të aplikantëve/kandidatëve

Sipas udhëzimit administrativ nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik Testi me shkrim vlerësohet deri në shtatëdhjetë (70) pikë

Intervista deri në njëzet (20) pikë

Jetë përshkrimi (CV) deri në dhjetë (10) pikë

Titulli i vendit të punës:	Depoist/e llogaritar
Ndërmarrja:	KOSTT - Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh.A.
Numri referues:	1.14.5.7
Kohëzgjatja e kontratës:	Për kohë të pacaktuar
Orari i punës:	Puna me orar të plotë
Lartësia e pagës bazë mujore:	587 euro
Numri i kryesve:	1
Kushtet e punës:	Puna në zyrë
Vendi i punës (lokacioni):	KOSTT Selia Qendrore-Prishtinë
Mënyra e aplikimit:	Adresa elektronike (email)

Përmbledhje e detyrave për pozitën: Depoist llogaritar

Detyra e Depoistit llogaritar është që ti asistoj Menaxherit të Sektorit të Menaxhimit të Objekteve në aktivitetet operative të depos së materialit të imët dhe materialit harxhues (inventories). Detyrat e përgjithshme të depoistit janë pranimi, shpaktimi, verifikim, strehim, distribuimi i materialit dhe evidentimi.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore

Detyrat e tij specifike dhe përgjegjësitë lidhur me logjistikën e depos janë:

- I asiston Menaxherit të Sektorit të Menaxhimit të Objekteve në organizimin e stoqeve dhe inventarit në pajtim me kërkesat ligjore të kompanisë.
- I asiston Menaxherit të Sektorit të Menaxhimit të Objekteve në sigurimin e stoqeve të mjaftueshme të inventarit duke kontrolluar furnizimet dhe caktimin e faturave për furnitorë.
- Ngarkimi dhe shkarkimi i mjeteve të ngarkuara.
- Pranimi i mallrave, sistemimi i tyre në vend të caktuar, etiketimi dhe shenjzimi i tyre në harmoni me procedurat e menaxhimit të depos.
- Lëshimi dhe komisionimi i mallrave sipas kërkesave dhe specifikimit të mallit.
- Vendosja dhe largimi i mallrave nga hapësira e depos.
- Mirëmban evidentimin e mallrave në harmoni me procedurat e evidentimit dhe procedurën mbi menaxhimin e depos.
- Mirëmban depon në gjendje të pastës dhe të rregullt.
- Mirëmbajtja e evidencave të mallit në depo dhe pjesëmarrja në regjistrimet vjetore të depos.
- Verifikon, identifikon dhe raporton dëmtimet eventuale gjegjësisht mbi cilësinë ashtu edhe sasinë e mallit të pranuar dhe të gjeturat tjera eventuale.
- Raporton për të gjitha mospërputhjet me kërkesat e bëra për furnizim me mall te menaxheri i Sektorit të Menaxhimit të Objekteve, respekton procedurat mbi masat e sigurisë.

Të tjera

Bashkëpunon me sektorin e kontabilitetit dhe prokurimin. Kryen punë të tjera të cilat kërkohen nga menaxheri i Sektorit të Menaxhimit të Objekteve dhe që janë të nevojshme për funksionim efektiv të KOSTT-it.

Kërkesat profesionale/Kualifikimet, aftësitë dhe shkathtësitë tjera:

Shkollimi: Shkollimi i mesëm i përfunduar

Dega/drejtimi/lëmia: /

- Përvojë pune 1 vit
- Praktikë në inxhinierinë elektrike, njohuri për materialet për zyra dhe materialet tjera të cilat arrijnë në depo.
- Njohuri bazë të punës me kompjuter.
- Njohuri bazë të gjuhës angleze.

Njoftimi me rezultatin e konkursit

Sipas udhëzimit administrativ nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik aplikantët/kandidatët do të njoftohen pas çdo faze të zhvillimit të procesit të vlerësimit të kandidatëve

Mënyra e vlerësimit të aplikantëve/kandidatëve

Sipas udhëzimit administrativ nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik Testi me shkrim vlerësohet deri në shtatëdhjetë (70) pikë

Intervista deri në njëzet (20) pikë

Jetë përshkrimi (CV) deri në dhjetë (10) pikë

Titulli i vendit të punës:	Inxhinier/e për testim, mirëmbajtje dhe akordim të releve
Ndërmarrja:	KOSTT - Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh.A.
Numri referues:	1.6.5.1
Kohëzgjatja e kontratës:	Për kohë të pacaktuar
Orari i punës:	Puna me orar të plotë
Lartësia e pagës bazë mujore:	1061 euro
Numri i kryesve:	1
Kushtet e punës:	Puna në zyre dhe në teren
Vendi i punës (lokacioni):	Selia Qendrore e KOSTT-it, Prishtinë
Mënyra e aplikimit:	Adresa elektronike (email)

Përmbledhje e detyrave për pozitën: Inxhinier/e për testim, mirëmbajtje dhe akordim të releve

Inxhinieri i Mbrojtjes mbështet Menaxherin e Mbrojtjes në lidhje me konceptin e mbrojtjes. Testimi i mbrojtjes rele dhe automatikës në nënstacionet e Transmisionit, dhe në bazë të kontratës edhe në pjesë të nënstacioneve të Distribucionit.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore

Inxhinieri i Mbrojtjes është i përfshirë në operimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e Sistemeve Mbrojtëse. Detyrat dhe përgjegjësitë e tij specifike janë që të:

- Ndihmon Menaxherin e Mbrojtjes në kryerjen e analizave të selektivitetit.

- Rregullisht monitoron sistemin e mbrojtjes dhe merr masa të menjëhershme në rast të devijimit të performancës.
- Mbështet Menaxherin e Mbrojtjes në mirëmbajtjen e shënimeve për performancën e rrjetit të transmisionit dhe incidenteve.
- Ndhmon Menaxherin e Mbrojtjes në përgatitjen e dhe monitorimin e metrikës së kualitetit të energjisë.
- Ndhmon Menaxherin e Mbrojtjes që të siguroj që të vendosën aranzhmane efikase për bashkërendimin operativ me Operatorin e Sistemit, përdoruesit e sistemit, dhe pjesëmarrësit e tregut.
- Siguroj që të vendosen aranzhmane efikase për bashkërendimin operativ me Operatorët e Transmisionit në vendet fqinje.
- Azhurnimi i test protokolleve të pajisjeve kontrolluese dhe i vizatimeve.
- Mirëmban bashkëpunim të ngushtë me planifikuesit e Selektivitetit të Mbrojtjes dhe me funksionet e kohës reale të Operimit të Rrjetit.
- Gjatë intervenimeve dhe riparimeve bënë përdorimin e drejtë të veglave dhe pajisjeve të punës, si dhe përkujdeset për procedurat e sigurisë në punë.
- Në koordinim me dispeçerët kryesor hap dhe mbyll urdhëresat e punës.
 - Intervenimet për prishjet në sistem elektroenergjetik në çdo kohë, nxjerrja e të dhënave për prishjen nga mbrojtjet rele në mënyrë që sistemi të rikthehet në punë në kohën sa më të shkurtë të mundshme
 - Realizon në teren ndërrimet periodike të mbrojtjeve rele të mbingarkesës në Linjat e Interkoneksionit me vendet fqinje
 - Realizon në teren ndërrimet periodike të mbrojtjeve rele të mbingarkesës në Linjat interne
 - Kalkulon dhe realizon në teren ndërrimin e parametrave të përkohshëm të mbrojtjeve rele në sistem për shkak të ndërrimit të konfiguracionit të përkohshëm të rrjetit Transmetues si shkak i realizimit të projekteve
 - Kalkulon dhe realizon në teren ndërrimin e parametrave të mbrojtjeve rele në sistem për shkak të ndërrimit të konfiguracionit të rrjetit Transmetues (shtimi dhe këputja e linjave dhe Transformatorëve të ri) si shkak i realizimit të projekteve
 - Merr pjesë në shqyrtimin dhe korrektimin e planeve, dizajneve dhe aprovimin e tyre në kuadër të zhvillimit të projekteve.
 - Merr pjesë në komisionim dhe përcjelljen e projekteve që zhvillohen në kuadër të zhvillimit të rrjetës elektroenergjetike të KOSTT-it, si dhe testimet e pajisjeve në kuadër të pranimit teknik (në Fabrike-FAT) apo në kuadër të lëshimit në punë në teren

Të tjera

Kryen detyra të tjera të cilat kërkohen nga Menaxheri i Mbrojtjes dhe të cilat kërkohen për funksionimin efektiv të KOSTT-it.

Kërkesat profesionale/Kualifikimet, aftësitë dhe shkathtësitë tjera:

Shkollimi: Diploma universitare

Dega/drejtimi/lëmia: Inxhinieri Elektrike

- Njohje të thellë të industrisë së shërbimeve publike në nivel lokal dhe global
- Përvojë në kompanitë e transmisionit dhe/ose operimin e sistemit
- Përvojë pune profesionale 2 vite
- Përvojë në sistemet mbrojtëse
- Njohja e gjuhës angleze

Njoftimi me rezultatin e konkursit

Sipas udhëzimit administrativ nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik aplikantët/kandidatët do të njoftohen pas çdo faze të zhvillimit të procesit të vlerësimit të kandidatëve

Mënyra e vlerësimit të aplikantëve/kandidatëve

Sipas udhëzimit administrativ nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik

Testi me shkrim vlerësohet deri në shtatëdhjetë (70) pikë

Intervista deri në njëzet (20) pikë

Jetë përshkrimi (CV) deri në dhjetë (10) pikë

Titulli i vendit të punës:	Inxhinier/e për planifikim operativ dhe analizë afat-shkurtë
Ndërmarrja:	KOSTT - Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh.A.
Numri referues:	1.7.5.2
Kohëzgjatja e kontratës:	Për kohë të pacaktuar
Orari i punës:	Puna me orar të plotë
Lartësia e pagës bazë mujore:	923 euro
Numri i kryesve:	1
Kushtet e punës:	Puna në zyre dhe në teren
Vendi i punës (lokacioni):	Selia Qendrore e KOSTT-it, Prishtinë
Mënyra e aplikimit:	Adresa elektronike (email)

Përmbledhje e detyrave për pozitën: Inxhinier/e për planifikim operativ dhe analizë afat-shkurtë

Inxhinieri i Planifikimit Operativ dhe Analizë Afat-shkurtë është përgjegjës për planifikimin e 24 orëve të ardhshme dhe bilancin e SEE të Kosovës.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore

Brenda kësaj detyrat dhe përgjegjësitë e tij specifike në Planifikim dhe Analizë janë:

Planifikimi dhe analiza e shkyçjeve

- Koordinimi dhe shqyrtimi i shkyçjeve me interkoneksion,
- Koordinimi dhe shqyrtimi i shkyçjeve të planifikuara nga Operatori i Transmisionit OT, nga Departamenti i Menaxhimit të Projekteve, SCADA dhe Telekom, i
- Koordinimi dhe shqyrtimi i shkyçjeve të planifikuara me KEK dhe KEDS,
- Koordinimi dhe shqyrtimi i shkyçjeve të pa-planifikuara,

- Implementimi i planeve nga WOPT (Weekly Outage Teleconference) dhe revidimi i planeve një ditë para në rast nevoje,
- Simulime me software-t dhe platformat në disponim me rastin e shkyçjeve për ditët në vijim,
- Llogaritjen e kongjestioneve me rastin e shkyçjeve të aprovuara,
- Vlrësimi i sigurisë së Sistemit Elektroenegjetik (PSSA),
- Bënë informimin përkatës “Letra informuese” për rastet kur shkyçjet e elementit të SEE shkaktojnë ndërprerje të furnizimit të konsumatorëve me energji elektrike,
- Mirëmbajtja e bazës së të dhënave për shkyçje,
- Analiza e modelit të rrjetit si dhe definimi i “topologjisë përfundimtare të rrjetit” bazuar në identifikimin e kongjestioneve të sistemit dhe ndërshtetërore si dhe hapave të nevojshëm për zgjidhjen e tyre,
- Përdorimi i sistemit SCADA, RMC platformës, Platformës Novita, NEPLAN-it, PSSE për analiza në kuadër të sferës së punëve të sektorit

Planifikimi dhe analiza e konsumit nacional të Kosovës një ditë para

- Analiza e konsumit nacional të Kosovës për ditët e kaluara,
- Analiza e temperaturave për ditët e kaluara dhe parashikimi i temperaturave për ditët në vijim,
- Parashikimi i konsumit nacional të Kosovës për ditën në vijim në baza orare (24 h), bazuar në të dhënat nga kompanitë e distribucionit / furnizimit dhe konsumatorët në tension të lartë dhe vlerësimeve vetanake të KOSTT-it, të premtën për tri ditë,
- Publikimi i të dhënave të planifikuara dhe të realizuara në platformën e transparencës përmes Entso-e Web dhe software-it eRepo, dhe në Web faqe të KOSTT,
- Përmbledh të dhënat për planin e prodhimit, bazuar në njoftimet nga gjeneruesit dhe informatat për transferet e importit/eksportit të cilat pranohen nga Operimit të Tregut.
- Parashikimi i nevojave për rregullim sekondar për ditën e nesërme, në baza orare.
- Mirëmbajtja e bazës së të dhënave për planifikimin dhe realizimin e konsumit nacional të Kosovës në baza orare.

Planifikimi dhe analiza e Humbjeve një ditë para

- Analiza e humbjeve në transmission (teknike) dhe konsumit të Veriut(humbjet e sistemit),
- Planifikimi i humbjeve në transmission për ditën në vijim në baza orare,
- Planifikimi i humbjeve në system (konsumi i veriut) për ditën në vijim në baza orare,
- Planifikimi i humbjeve në transmission me anë të softwerit NEPLAN,
- Mirëmbajtja e bazës së të dhënave për planifikimin dhe realizimin e humbjeve në transmission dhe
- Analiza e jobalanceve të humbjeve.

Llogaritja e devijimeve të sistemit dhe kompensimit

- Përpilimi dhe raportimi (përfshir korrigjimet e nevojshme) i të dhënave në bazen e shenimeve për ditën paraprake, me të dhënat e marrura nga Operatori i tregut (SOVA)15 min dhe sektori i matjeve, Konvertimi i shenimeve të aFRR dhe mFRR dhe linjave interkonektive në baza orare,
- Llogaritja e devijimeve,
- Llogaritja e kompensimit për devijimet e shkaktuara gjatë periudhës paraprake në raport me programin e deklaruar dhe të aprovuar të asaj periudhe kohore, si dhe harmonizimi me palët interkonektive (TSO e shteteve tjera).
- Mirëmbajtja e bazës së shenimeve,
- Raporti i aktivizimit të mFRR,
- Profilizimi i HC Ujmanit dhe konsumit të veriut,
- Shkëmbimi i shenimeve me OST.

Analiza e sistemit për ditën në vijim

- Pranimi i programit për ditën në vijim,
- Analiza e programit (prodhimi, kërkesën, shkëmbimin e energjisë, NTC kapaciteti transmetues i rrjetit),
- Kalkulon kapacitetin e transmetues të rrjetit NTC për ditën në vijim,
- Konfirmimi i programit për ditën në vijim,
- Llogaritja e mungesave të energjisë,
- Përgatit planet për reduktime në rast të mungesës së energjisë,
- Krijimi i topologjisë së sistemit për ditën në vijim,
- Përgatit planin e përgjithshëm të funksionimit të sistemit (prodhimit, topologjia, net import/exporti, konsumi dhe humbjet) një ditë para, së bashku me një plan për rezervën e sistemit.

Raportimet në ZRRE, KEK, KESCO, ME, ASK etj

- Analiza e sistemit në ditën D+1 pas përfundimit të procesit të accountingut,
- Raportimet për ZRRE, MZHE, KESCO, KEK, UJMAN për gjendjen e sistemit për ditën e kaluar,
- Përgatitja dhe dërgimi i të dhënave të ndryshme sipas kërkesave të institucioneve vendore ZRRE, ME, ASK etj,
- Përgatitja dhe dërgimi i raporteve me rastin e rënieve të gjeneratorëve BRE të kyçur në sistemin e transmisionit,
- Analiza pasoperative e aplikimit të mekanizmit balancues për ditën paraprake, si dhe përpilimi i raportit për Dep. e Operatorit të Tregut.

Krijimi i modelit të rrjetit

- Krijimi i modelit individual të rrjetit (IGM) në formatin e caktuar,
- Krijimi, analizimi dhe procedimi i DACF fajllit (Day ahead congestion forecast) për ditën e nesërme, si dhe shkëmbimi i tij me qendrën koordinative të ENTSO-E, i 24 modeleve në baza orare,
- Pranimi i modelit European të bashkuar (merged model), analizimi dhe revidimi eventual konform koordinimit me TSO-ot e shteteve tjera,
- Krijimi i snapshot-ve (SN) të sistemit,
- Shkëmbimi i të dhënave mbi modelin e rrjetit të Kosovës me qendrën RSC (Regional Security Coordinator).
- Mirëmbajtja dhe freskimi i software-ve në disponim me elementet e reja të sistemit.
- Mirëmbaj parashikimin e kërkesës një për ditën e ardhshme, bazuar në të dhënat nga kompanitë e distribuicionit / furnizimit dhe konsumatorët në tension të lartë dhe vlerësimeve vetanake të KOSTT-it.
- Përmbledh të dhënat për planin e prodhimit, bazuar në njoftimet nga gjeneruesit dhe informatat për transferet e importit/eksportit të cilat pranohen nga Grupi i Operimit të Tregut.
- Përgatit planin e përgjithshëm të prodhimit për një ditë para, së bashku me një plan për rezervën e sistemit.
- Vlerëson sigurinë e rrjetit në baza orare për ditën e ardhshme.
- Përmbledh të dhënat për transferet fizike të kontraktuara, njësi për njësi dhe për importin dhe eksportin për linja.
- Koordinon me zonat kontrolluese fqinje: rishikon transferet e planifikuara dhe konfirmon transferet e kontraktuara.
- Koordinimi me Operatorin e tregut për përpilimin të programit ditor për ditën e nesërme

- Koordinimi me Dep. e Transmetimit , Departamentin e Zhvillimit të Projekteve dhe KEDS për realizimin e programeve të çkyçjeve në lidhje me planin e mirëmbajtjes , realizimin e çkyçjeve të nevojshme për realizimin e projekteve të parapara
- Koordinimi i importeve & eksporteve një ditë përpara
- Parashikimi i humbjeve teknike dhe të sistemit për rrjetin transmetues të KOSTT për ditën pasuese
- Parashikimi i nevojave për rregullim sekondar për ditën e nesërme, në baza orare
- Përpilimi dhe raportimi (përfshir korrigjimet e nevojshme) i shënimeve në ditarin dispeçerik për ditën paraprake, ashtu që Dep. i Op. Të Tregut të realizoi ‘ barazimin përfundimtar’
- Llogaritja e kompensimit për devijimet e shkaktuara gjatë periudhës javore paraprake në raport me programin e deklaruar dhe të aprovuar të asaj periudhe kohore, si dhe harmonizimi me palët interkonektive (TSO e shteteve tjera).
- Krijimi, analizimi dhe procedimi i DACF fajllit (Day ahead congestion forecast) për ditën e nesërme, si dhe shkëmbimi i tij me qendrën koordinatave të ENTSO-E, i 24 modeleve në baza orare.
- Pranimi i modelit European të bashkuar (merged model), analizimi dhe revidimi eventual konform koordinimit me TSO-ot e shteteve tjera
- Shkëmbimi i të dhënave mbi modelin rrjetit të Kosovës me qendrën RSC (Regional Security Coordinator)
- Përgatitja e shënimeve për koordinim të çkyçjeve te rrjetit horizontal regjional - Europës juglindore, në WOPT (Weekly Operational Teleconference)
- Koordinimi dhe shqyrtimi i shkyçjeve të paplanifikuara (intervente)
- Koordinimi i mirëmbajtjes dhe planeve të shkyçjeve të planifikuara
- një javë para
- një ditë para
- Menagjimi dhe mirëmbajtja e bazës së të dhënave për shkyçje, bazës së të dhënave të parashikimit të ngarkesës dhe bazës së të dhënave për humbjet në transmision .
- Aanaliza e sistemit një ditë pas (raportimet për ZRRE, MZHE, KESCO, KEK, UJMAN etj)
- Përpilimi i raportit për incidente javore të devijimeve, dhe dërgimi tek palët relevante të sektorit energjetik të Kosovës
- Mirëmbajtja dhe freskimi i modelit të rrjetit me elemente të reja të shtuara të sistemit, me paketin softuerik NEPLAN.
- Bënë informimin përkatës për rastet kur shkyçjet e elementit të SEE shkaktojnë ndërprerje të furnizimit me energji elektrike
- Përdorimi i sistemit SCADA/EMS/SCS, AMR-ës, Platformës së tregut dhe NEPLAN-it për analiza në kuadër të sferës së punëve të sektorit
- Analiza e modelit të rrjetit si dhe definimi i “topologjisë përfundimtare të rrjetit” bazuar në identifikimin e kongjestionëve interne dhe ndërshtetërore si dhe hapave të nevojshëm për zgjidhjen e tyre
- Analiza pasoperative e aplikimit të mekanizmit balancues për ditën paraprake, si dhe përpilimi i raportit për Dep. e Operatorit të Tregut
- Llogaritja e indikatorve të kualitetit të furnizimit SAID-i, SAIF-i, edhe ENS, për periudhat kohore kur kishte shkyçje të planifikuara dhe të pa planifikuara.

- Në mungesë të alokimit të detyrave tek Dep.Operatori i Tregut (e mundëson ligji i en.el. të Kosovës bartjen e disa detyrave të SO tek MO), sektori për Planifikim Afatshkurtër kryen edhe:
- Analizat para dhe pas operative të “Mekanizmit balancues”
- Rregullimi bilancit / prokurimi i shërbimeve ndihmëse
- Planifikimi i padetyrueshëm
- Pranimi dhe validimi i ofertave të balancimit të tregut
- Gatishmëria e kapacitetit
- Mirëmban procesin e menaxhimit për operimin përcjellës të bilancit të sistemit dhe planit, si dhe qasjes (24 orë) planifikimi i bilancit elektroenergjetik duke përfshirë prodhimin, kërkesën shkëmbimin e energjisë dhe tranzitin në SEE të Kosovës.
- Menaxhon planet për reduktime.

Të tjera

- Kryej detyra të tjera të cilat kërkohen nga Drejtori i Operimit të Sistemit dhe të cilat janë të nevojshme për funksionimin efektiv të KOSTT-it.

Kërkesat profesionale/Kualifikimet, aftësitë dhe shkathtësitë tjera:

Shkollimi: Diploma universitare

Dega/drejtimi/lëmia: Inxhinieri Elektrike

- 1 vjet përvojë pune në sektorin energjetik
- Përvojë në shkëmbim të energjisë, transmision dhe/ose operim të sistemit
- Përvojë në sistemet informative të qendrës dispeçerike
- Njohuri të industrisë së Shërbimeve Publike në nivel lokal dhe global
- Njohja e mirë e gjuhës angleze

Njoftimi me rezultatin e konkursit

Sipas udhëzimit administrativ nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik aplikantët/kandidatët do të njoftohen pas çdo faze të zhvillimit të procesit të vlerësimit të kandidatëve

Mënyra e vlerësimit të aplikantëve/kandidatëve

Sipas udhëzimit administrativ nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik Testi me shkrim vlerësohet deri në shtatëdhjetë (70) pikë

Intervista deri në njëzet (20) pikë

Jetë përshkrimi (CV) deri në dhjetë (10) pikë

Mënyra e aplikimit

Aplikimi bëhet përmes email adresës elektronike. Dokumentet duhet të ngarkohen sipas kërkesave të konkursit. Pasi të dërgoni aplikimin tuaj përmes email adresës elektronike do të pranoni një email për konfirmim të pranimit të email-it tuaj. Nëse nuk keni pranuar email-in konfirmues, atëherë shkruani në email adresën punesimi@kostt.com (vetëm në rastin kur pas aplikimit nuk e keni pranuar email-in konfirmues).

Dokumentet që duhet të ngarkohen dhe dërgohen si pjesë e aplikimit dhe mënyra e dërgimit të tyre:

Gjatë aplikimit për pozitën në fjalë kandidatët duhet të kenë kujdes hapat e aplikimit:

- Aplikimi bëhet vetëm përmes adresës (postës) elektronike (email) punesimi@kostt.com
- Në email për aplikim duhet të bashkangjiten (ngarkohen) dokumentet si në vijim:
 - Aplikacionin-CV-në (**ver. 4.0**) të shkarkuar nga web faqja zyrtare e KOSTT Sh. A. www.kostt.com
 - Dëshmia për kualifikimin profesional: Diploma universitare, e skanuar në formatin pdf dhe e bashkangjitur në email (*nëse diploma është fituar jashtë vendit duhet bashkangjitur vërtetimin e nostrifikimit të diplomës apo aktin që dëshmon se diploma është në procedurë të nostrifikimit me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të kontratës së punës*)
 - Dëshmia për përvojën profesionale: Vërtetim pune (referencë) nga punëdhënësit tuaj të mëparshëm apo aktual me të cilën vërtetohet përvoja juaj për profesionin që keni. Në vërtetim (referencë) duhet të jetë data e fillimit dhe mbarimit të punësimit apo angazhimit tuaj tek punëdhënësi juaj.
 - Dëshmi tjera të dokumenteve sipas kërkesave dhe kriterëve të konkursit publik.

KOSTT ofron mundësi të barabarta të punësimit për gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës si dhe inkurajon kandidatët e gjinisë femërore dhe të rinjtë që të aplikojnë për këto vende pune.

Vërejtje: Gjatë aplikimit, aplikantët/kandidatët duhet të kenë gjithashtu kujdes, si në vijim:

Nëse nuk e deklaroni që anëtari i familjes suaj është në marrëdhënie pune me KOSTT, në cilëndo fazë të zhvillimit të vlerësimit të kandidatit që vërtetohet, aplikacionet-CV-të tuaja do të refuzohen.

Aplikacionet e dërguara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa ato të mangëta ose ato që nuk janë në formatin e kërkuar më lartë do të refuzohen.

Aplikacionet do të pranohen vetëm nga kandidatët, të cilët i plotësojnë kërkesat/kriteret e konkursit të shpallur në mjetet e informimit dhe në webfaqen zyrtare të KOSTT-it.

Dokumentacioni shtesë të dërguara nga kandidati pas përfundimit të afatit të aplikimit nuk mund të kërkohej dhe as të pranohet.

Kalendari i përafërt: Pas përfundimit të afatit të aplikimit, brenda 20 dite testimi me shkrim, brenda 15 dite intervista, brenda 5 dite njoftimi final, si dhe brenda 15 dite lidhje e marrëdhënies së punës me kandidatin e suksesshëm.

Kalendari i përafërt do të aplikohet në rast se nuk ka ankesa të cilat e pezullojnë afatin e paraparë të rrjedhës së procesit të konkursit sipas UA nr. 01/2024.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit dhe në webfaqen e KOSTT, nga data 01.11.2024 deri më 15.11.2024 ora 24:00.